VENDIM
Nr. 239, datë 22.9.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "f", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 1539 prot., datë 13.9.2022, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.",

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 257, datë 21.12.2020 ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.
- Në pikën 1.2 dhe pikën 2 të Programit të Pajtueshmërisë parashikohet, se: OSSH sh.a. përcakton, zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.
- Duke qenë se në zbatim të përcaktimeve si më sipër OSSH sh.a. nuk kishte caktuar zyrtarin e pajtueshmërisë, ERE me vendimin nr. 18/2022 vendosi që brenda 30 ditëve pune nga marrja e këtij vendimi dhe pas miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë, OSSH sh.a. duhet të përcillte për miratim në ERE kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, duke përfshirë si pjesë integrale dhe kriteret përzgjedhëse të tij.
- Në vijim, duke u bazuar te kërkesa e OSSH sh.a., e depozituar përpara përfundimit të këtij afati, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 11.4.2022 vendosi të zgjasë afatin për depozitimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë deri më 30.6.2022.
- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën nr. 289/3 prot., datë 21.4.2022 dhe me shkresën nr. 289/4, datë 23.6.2022 i është rikujtuar detyrimi për të depozituar në afat dokumentacionin e kërkuar. Rezulton që edhe pas përfundimit të afatit OSSH sh.a. nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.
- Nisur nga nevoja për të emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili do të monitorojë dhe do të raportojë mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë u vlerësua që ERE, me nismën e saj të hartojë kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes së tij, dhe të fillojë procedurën për miratimin e saj.
- Ky dokument është hartuar duke u bazuar dhe në procedura të mëparshme të ngjashme, si kontrata për ofrimin e shërbimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a., si dhe zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror.
- Në këtë dokument përcaktohen dhe detyrat/shërbimet e zyrtarit të pajtueshmërisë, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe për raportimin e këtij zbatimi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe në vetë Programin e Pajtueshmërisë.
- Në kontratë gjejnë parashikim në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke përfshirë shërbimet që duhet të ofrojë zyrtari, të drejtat e zyrtarit, të drejtat dhe detyrimet e OSSH sh.a., pagesat dhe detyrimet financiare për shërbimet e zyrtarit, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Për sa i përket pagesës së zyrtarit të pajtueshmërisë, ajo duhet të caktohet nga OSSH sh.a.

- Kjo kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo nënshkruhet nga palët dhe mandati i zyrtarit të pajtueshmërisë fillon ditën tjetër të punës pas nënshkrimit. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e nënshkrimit.

- Në shtojcën 1, përfshihen kriteret përzgjedhëse të zyrtarit të pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti